## KARTELË INFORMATIVE

**AL012084**

| | |
|---|---|
| **1. Emri i shërbimit** | *Akreditimi i ofruesve të edukimit në vazhdim për profesionistët e shëndetësisë* |
| **2. Cili është qëllimi i shërbimit?** | *Ky shërbim ka si qëllim garantimin e standardeve dhe kritereve që duhet të plotësojë një institucion/organizatë, për të marrë statusin e ofruesit të akredituar të aktiviteteve të edukimit ne vazhdim për profesionistët e shëndetësisë* |
| **3. Çfarë ofron ky shërbim?** | *Nëpërmjet rritjes së cilësisë së edukimit në vazhdim për profesionistët e shëndetësisë, nga institucione/organizatat e akredituara në profilet përkatëse, të cilat garantojnë cilësi dhe siguri në procesin e edukimit në vazhdim të profesionistëve të shëndetësisë, qytetarit synohet ti ofrohet një shërbim shëndetësor sa më cilësor.* |
| **4. A jam përfitues?** | *Përfitues mund të jenë të gjitha strukturat publike ose private, akademike ose jo akademike, fitimprurëse ose jofitimprurëse, që kanë ekspertizën dhe eksperiencën e duhur në organizimin e aktiviteteve të edukimit në vazhdim në fushën e shëndetësisë dhe që plotësojnë standardet e kriteret e paraqitura.* |

**5. Çfarë dokumentesh duhen për aplikim?**

| Nr | Lloji | Dokumenti lëshohet nga: | Dorëzohet në sportel nga aplikanti? |
|---|---|---|---|
| 1 | *Kërkesë për akreditim* | *Institucioni/Aplikanti* | *Po* |
| 2 | *Statuti ligjor i ofruesit.* | *Aplikanti* | *Po* |
| 3 | *Listën e të gjitha vendimeve të marra nga QKEV lidhur me miratimin, refuzimin, anullimin ose rishikimin e numrit të krediteve për aktivitetet e edukimit në vazhdim të organizuara në 5 vitet e fundit nga data e aplikimit për akreditim* | *Institucioni/Aplikanti* | *Po* |
| 4 | *Bilanci financiar i vitit të fundit* | *Aplikanti* | *Po* |
| 5 | *Kontratat e punës /shërbimit /konsulencës për çdo punonjës, anëtarët e komitetit shkencor, koordinatori/ët shkencorë apo persona të tjerë që lidhen me menaxhimin e aktiviteteve të edukimit në vazhdim. Këto kontrata duhet të përfshijnë përshkrimin e punës për çdo person.* | *Aplikanti* | *Po* |
| 6 | *Lista e punonjësve e vërtetuar nga zyra e tatimeve* | *Drejtoria Rajonale e Tatimeve/ Aplikanti* | *Po* |
| 7 | *Plani i detajuar i aktiviteteve të edukimit në vazhdim për 6 muaj deri në një vit nga data e aplikimit për akreditim të ofruesit. Plani i aktiviteteve të shoqërohet me vlerësimin e nevojave të profesionistëve për edukimin në vazhdim, sipas kategorive të tyre.* | *Institucioni/ organizata* | *Po* |
| 8 | *Pagesa e tarifës së akreditimit.* | *Banka* | *Po* |

**6. Ku mund të aplikoj?**

| Zyrat pritëse | Qyteti | Adresa | Orari |
|---|---|---|---|
| *Qendra Kombëtare Edukimit në Vazhdim QKEV* | *Tiranë* | *Rr. "Aleksander Moisiu" Nr 84. Tiranë* | *E hënë- e enjte, ora 08:00 - 16.30*<br>*E premte, ora 08:00- 14:00* |

**7. A është ky shërbim online?**

| Niveli 1 | Niveli 2 | Niveli 3 | Niveli 4 |
|---|---|---|---|
| *Ofrohet informacion mbi shërbimin* | *Ofrohet informacion dhe mundësi shkarkimi i formularit të aplikimit* | *Ofrohet informacion dhe mundësi për dorëzimin e aplikimit online* | *Shërbimi ofrohet tërësisht online* |
| [X] | [ ] | [ ] | [ ] |

**8. Sa është tarifa për marrjen e shërbimit?**

| Tarifa bazë | Tarifa shtesë | Tarifa Online | Mënyra e pagesës |
|---|---|---|---|
| *50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë për akreditimin e përkohshëm të ofruesit;*<br>*100 000 (njëqind mijë) lekë për proçedurat e akreditimit afatgjatë dhe të rinovimit të akreditimit* | *Nuk ka* | | *Në një bankë (ose në disa banka), jashtë institucionit* |

| | |
|---|---|
| **9. Sa kohë nevojitet për të marrë shërbimin?** | *6 muaj nga aplikimi* |
| **10. Çfarë përfitoj?** | *Shkresë miratim/refuzim akreditimi nga titullari i QKEV-së* |
| **11. Ç'afat vlefshmërie ka?** | *2 vjet vlefshmëri për akreditimin e përkohshëm*<br>*4 vjet vlefshmëri për akreditim afatgjatë* |
| **12. Ku e marr?** | *Në sportele* [ ] *Me postë* [X] *E-albania* [ ] *Me e-mail* [X] |
| **13. Cili është institucioni përgjegjës?** | *Qendra Kombëtare e Edukimit në Vazhdim (QKEV)* |

**14. Ku mund të gjej informacion për këtë shërbim?**

| Kontakto në: | Orari |
|---|---|
| *E- albania:e-albania.al*<br>*ADISA web: www.adisa.gov.al*<br>*ADISA email: Informacion@adisa.gov.al*<br>*QKEV web: www.qkev.gov.al/*<br>*Qendra e Informimit mbi Shërbimet Publike:* ***0800 0118*** | *Qendra e Informimit mbi Shërbimet Publike:*<br>*E Hënë- E Premte, ora 08:00- 19:00* |

**15. Nëse kam ankesë, si të veproj?**

*Në sportele* [X] *Me postë* [X] *Web-i i Institucionit* [ ] *Me e-mail* [X]

*Në platformën "Shqipëria që duam"* [X]
*Link: www.shqiperiaqeduam.al*

**16. Cila është baza ligjore e këtij shërbimi?**

*Ligj Nr.10 107, datë 30.3.2009 "Për kujdesin shëndetsor në Republikën e Shqipërisë" (Ndryshuar me ligjin nr. 51/2013, datë 14.2.2013) (Ndryshuar me ligjin nr.76/2015,datë 16.7.2015) Neni 33/1*
*Vendim i Këshillit të Ministrave Nr.440 datë 17/05/2017 i ndryshuar me vendim nr 394 date 27/06/2018 "Për Përcaktimin e Standardeve Kritereve dhe Procedurave të Akreditimit të Ofruesve të Aktiviteteve të Edukimit në Vazhdim për Profesionistët e Shëndetësisë";*